



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (KGJ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Detyrimet kontingjente (14,427,529€) të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar ishin të mbivlerësuara për 301,299€.
- B1 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike në vlerë 330,194€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna për projektin "Ndërtimi i tregut të gjelbër në Komunën e Gjilanit" në vlerë 509,177€, kishte aplikuar procedurën jo adekuate të prokurimit;
- A3 Kontrata publike kornizë e lidhur me çmim për njësi për "Rregullimin dhe hapjen e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra" ishte tejkualuar për 72,000€;
- A4 Komuna kishte bërë subvencionimin e Organizatës Joqeveritare në vlerë 17,350€, pa bërë thirrje publike;
- B2 Për pagesat në vlerë prej 857,352€ nuk ishin respektuar hapat për procedim të pagesave;
- B3 Te kontrata publike kornizë "Sanimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytetin e Gjilanit" ishin bërë tejkualime të sasive indikative për 15 pozicione;
- A5 Komuna kishte paguar 29,688€ për pastrimin e objekteve shkollore të cilat nuk i kishte të parapara me kontratë;
- C1 Komuna obligimet financiare ndaj shpronësimeve nuk i kishte paguar brenda afatit të përcaktuar me vendime për shpronësim;
- B4 Komuna kishte bërë mbivlerësimin e pasurive kapitale duke regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale pasuritë që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime si dhe kishte bërë regjistrimin e tyre në klasën joadekuate të pasurive; dhe
- A6 Komuna kishte angazhuar të punësuar me kontratë për shërbime të veçanta pa i respektuar procedurat e prokurimit publik.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Komuna nuk kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, kjo për arsye se sistemi e-pasuria ende nuk është funksional, në mungesë të saj, të dhënat për pasurinë jo kapitale regjistrohen dhe evidentohen në formatin excel.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, mos respektimi i procedurave të prokurimit, hyrja në obligime pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, të arkëtueshmet, dobësi në regjistrimin e pasurisë jo financiare, përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korigjimet e mundshme. Megjithatë çështjet që ndërlidhen me Detyrimet kontingjente dhe Keqklasifikimet, janë paraqitur jo saktë dhe drejtë në PFV. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se aneksi (regjistri) i detyrimeve kontingjente i cili ishte bashkangjitur PFV-ve nuk ishte i saktë për shkak të dyfishimit të vlerave dhe si rezultat ka ndikuar që detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2021, të jenë të mbivlerësuara. Ne kemi kërkuar nga komuna që të bëhen korigjimet e aneksit dhe pas kërkesës sonë, pasqyrat së bashku me aneksin janë korigjuar dhe dorëzuar në thesar mirëpo ato prapë ishin të mbivlerësuara për shkak se katër padi të bëra ndaj komunës në vlerë totale prej 301,299€, ishin të regjistruar nga dy herë në regjistrat e detyrimeve kontingjente.

Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe nga pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm nga zyrtari kryesor financiar për t'i verifikuar vlerat gjatë prezantimit të detyrimeve kontingjente PFV.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur

me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontingjente në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

Gjetja Udhëzim Administrativ MF-nr.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale parasheh se "Data kur asetit është për herë të parë i gatshëm për përdorim dhe në gjendje të përdoret siç është menduar është data e komisionimit (pranimi teknik) të asetit. Nga kjo datë, shpenzimet e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes konsiderohen si shpenzime rrjedhëse" Po ashtu, neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë".

Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 330,194€, ku nga kategori investimet kapitale kishte paguar për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale si dhe mirëmbajtjen verore të rrugëve në vlerë 181,821€, të cilat sipas udhëzimit konsiderohen mallra dhe shërbime ndërsa vlera prej 118,693€, ishte paguar nga thesari sipas vendimit përmbartimor për shpronësimin e tokave nga kategoria mallra dhe shërbime dhe komunalit si dhe 29,680€, nga kategoria subvencionet për shpronësimin e tokave.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Përdorimi i gabuar i procedurës së prokurimit

Gjetja

Neni 52 i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh si procedurë shumë të jashtëzakonshme përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kjo procedura për kontratat punë ose shërbime sipas rregullës përdoret në rastin: Për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara (OE i njëjtë ekzekuton shërbimet ose punët shtesë, që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10% e vlerës së kontratës origjinale); dhe Për shërbime ose punë të reja që përbehen nga përsëritja e punëve ose shërbimeve të ngjashme që i janë besuar OE që i nënshtrohet disa kushteve të caktuara (janë në përputhje me projektin bazë, kjo mundësi është e zbuluar në tender, ndodh brenda 2 viteve pas përfundimit të kontratës fillestare si dhe vlera nuk është më shumë se 10% të vlerës së kontratës origjinale).

Komuna me datën 14.03.2019 kishte lidhë kontratë në vlerë 871,173€, për projektin "Ndërtimi i tregut të gjelbër në Komunën e Gjilanit", projekt ky që sipas menaxherit të projektit nuk ka mund të finalizohet për shkak të mangësive të sasive si dhe mungesës së pozicioneve të veçanta në paramasë dhe paralogari në raport me projektin. Me ç'rast menaxheri i projektit e njofton zyrën e prokurimit për pengesat e hasura në realizimin e këtij projekti. Zyra e prokurimit, marr parasysh këtë ka konsideruar si urgjente dhe të domosdoshme kryerjen e punëve shtesë në mënyrë që mos të rrezikohet investimi si dhe nevojën e domosdoshme të tregtarëve për tregun, aplikon procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duke ju dërguar ftesë për negociata tre Operatorëve Ekonomik (OE). Vetëm operatori fitues i cili njëkohësisht kishte kontratën bazë, e dërgon ofertën financiare. Pas vlerësimit të ofertës komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës të prokurimit dhënien e kontratës. Me datën 22.04.2021, lidhet kontrata në vlerë 509,177€. Në këtë rast zyra e prokurimit marr parasysh kërkesat e rregullës dhe udhëzuesit duhej të përdorte procedurën e hapur të prokurimit.

Vlen të theksohet se ky projekt ende nuk ishte përfunduar deri sa ne ishim në terren (04.03.2022), pavarësisht që sipas planit dinamik ka pas të përfundoj brenda 90 ditëve.

Sipas komunës kjo ka ndodh për shkak të nevojës emergjente lidhur me investimin për tregun.

Ndikimi

Aplikimi i procedurës jo adekuate mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës, lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë se aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore, duke siguruar se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas LPP.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Tejkalim i kontratës publike kornizë**

Gjetja Neni 56.15 Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit" artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi".

Komuna me datën 17.12.2020 kishte lidhur kontratë publike kornizë me çmim për njësi për "Rregullimin dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra" në vlerë 240,000€. Në kemi vërejtur se komuna kishte bërë tejkalim të kontratës për 72,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak se menaxheri i kontratës nuk ka pas njohuri që për kontratat publike kornizë të lidhura me çmim për njësi nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Ndikimi Tejkalimi i kontratave publike kornizë ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Subvencionimi i OJQ-së pa bërë thirrje publike**

Gjetja Neni 12 paragrafi 1 i Rregullore MF-nr.-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, parasheh se "Çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare".

Në emër të manifestimit "Flaka e Janarit 2021", Kryetari i Komunës me vendim të datës 23.04.2021, kishte subvencionuar Organizatën Joqeveritare (OJQ) "Vepro" në vlerë 17,350€, pa bërë thirrje publike siç kërkohet me rregullore.

Sipas komunës kjo kishte ndodhur për shkak të gjendjes pandemike.

Ndikimi Subvencionimi i OJQ vetëm me vendim nga kryetari pa bërë thirrjen publike, përjashton konkurrencën, transparencën si dhe ndikon në trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që për mbështetja

financiare për OJQ-të të bëhet me thirrje publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Pagesa e kryer për shërbimet e pa kontraktuara

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, i përcakton përgjegjësitë e menaxhrit të projektit si: pika 61.19 Menaxheri i Projektit do të: b) sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, pika 61.21 Mbikqyrësit i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për: a) mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të implementimit të kontratës, b) administrimin e plotë të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë, pika 61.23 Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit si dhe pika 61.24 Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para: a) Marrjes së aprovimit nga ZKA; b) Zotimit të mjeteve për kontratën e amandamentua.

Te kontrata publike kornizë “Pastrimi i objekteve shkollore në Komunën e Gjilanit” e datës 15.03.2019, në vlerë 1,256,050€, kemi identifikuar se te pagesa në vlerë 37,985€, ishte përfshirë edhe pastrimi i 12 shkollave të cilat nuk ishin të parapara në kontratën kornizë. Vlera e paguar për pastrimin e këtyre shkollave ishte 29,688€.

Sipas zyrterve komunal kjo ka ndodhur si rezultat i kërkesave për pastrim gjeneral të objekteve shkollore-arsimore lidhur me gjendjen pandemike me Covid-19.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar lidhur realizimin e punëve jo në pajtim me kontratën, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për kontratat publike kornizë si dhe mund të rezultojë me pagesa përtej buxhetit të planifikuar, apo në obligime të pa planifikuara, të cilat mund të kenë implikime buxhetore.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e nënshkrimit të kontratave publike kornizë fillimisht të bëjë një analizë të mirëfilltë të nevojave reale, në mënyrë që gjatë ekzekutimit mos të kryhen shërbime apo pozicione që nuk kanë qenë të përfshira në specifikacionin e kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta

Gjetja Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”.

Komuna në vitin 2021 kishte angazhuar 103 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta. Ne kemi testuar pesë (5) mostra dhe kemi identifikuar

se komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit publik për angazhimin e tyre. Kontratat e nënshkruara mes Komunës dhe të angazhuarve ishin për tre persona të angazhuar në zyrën e prokurimit, një në zyrën e gjendjes civile dhe një tjetër në drejtorinë e inspeksionit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e veprimeve jo adekuate, duke iu shmangur kërkesave të parapara me ligjin e zyrtarëve publik.

Ndikimi Moszbatimi i kritereve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta mund të cenon parimin e konkurrencës, transparencës si dhe mund të ndikoj në diskriminimin e të tjerëve.

Rekomandimi A6 Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 68 mostrat të testuara si pjesë e testimeve substanciale në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe Investimeve Kapitale, kemi vërejt se në 13 raste në vlerë 429,710€, për investime kapitale dhe 13 raste në vlerë 482,287€, për mallra dhe shërbime nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është sjellë situacioni për punët/ malli dhe shërbimet e pranuar dhe fatura e pastaj është lëshuar Urdhërblerja. Vlen të theksohet se ishte dukuri mjaft e shprehur rastin kur situacioni i ofruar nga operatori ekonomik për punën e kryer ishte shumëfish më i lart se sa urdhërblerja, zotimi dhe fatura.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhërblerjes.

Ndikimi Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave po shkakton rritjen e madhe të obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik pasi që situatat e punëve të kryera po janë shumë me të larta sesa zotimet dhe urdhërblerja e nxjerr nga zyra e prokurimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Dobësi në definimin e sasive në kontratat publike kornizë**Gjetja**

Ligji i prokurimit publik 04/L-042 dhe Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, pika 56.10 sa i përket kontratave kornizë përcaktojnë se: Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë plus/minus tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Te pagesa në vlerë 54,645€, e kontratës publike kornizë, “Sanimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytetin e Gjilanit “ e datës 20.12.2018, në vlerë 181,796€, kemi identifikuar tejkallim të sasive në 15 pozicione të situacionit të punëve të kryera në vlerë 25,301€, në krahasim me sasinë e kontraktuar. Vlen të theksohet se vlera e kontratës nuk është tejkalluar.

Ndër tejkallimet përtej mospërputhjes së lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) janë:

Në pozicionin Nr.76. “Mbajtës- gyp metalik Φ48 mm me gjatësi 90 cm i thyer në pjese nën këndin 105 shkallë në të cilin do te vendoset tr. ndriçues 150 W (50cmx50cm kënd deri 105 shkallë)”, të situacionit të kryer, sasia ishte 413 copë, ndërsa në kontratë sasia për këtë pozicion ishte 30 copë;

Në pozicionin Nr.106. “Angazhimi i kamionetës (shportës) për qëllime të caktuara (vendosja dhe largimi i flamujve, dekorimeve, etj.) për ditët e festave dhe ceremonive tjera zyrtare”, të situacionit të kryer, sasia ishte 250 h(orë), ndërsa në kontratë sasia për këtë pozicion ishte 15 h(orë); dhe

Në pozicionin Nr.114. “Dekorimi i drunjëve ekzistues natyror ne qytet me LED shirit”, të situacionit të kryer, sasia ishte 5800 m2, ndërsa në kontratë sasia për këtë pozicion ishte 2900 m2.

Mospërputhjet mbi limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicion/artikull, kanë ndodhur si rezultat i mangësive në kontrollet e brendshme lidhur me planifikimin dhe definimin e drejtë të sasive në kontratë.

Ndikimi

Tejkallimi i mospërputhjeve mbi limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicion/artikull, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për kontratat publike kornizë si dhe mund të rezultoj me pagesa përtej buxhetit të planifikuar për ato projekte dhe vështirson realizimin e projekteve të tjera të planifikuara.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrole të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkallim të sasive të kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Dobësi në regjistrimin e pasurive kapitale****Gjetja**

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe Neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria.

Lidhur me pasuritë kapitale janë evidentuar mangësitë në vijim:

Pasuria në vlerë 174,500€ për shpronësim të tokës, në regjistër të pasurisë, figuron në klasën e pasurisë investimet në vijim, ndonëse ishin realizuar të gjitha pagesat sipas akt-vlerësimit, dhe duhet të regjistrohet në klasën e pasurisë, toka, në regjistër të pasurisë.

Pasuria në vlerë 34,947€ për asfaltim të rrugës, në regjistër të pasurisë, figuron në klasën e pasurisë investimet në vijim, ndonëse ishin realizuar të gjitha pagesat sipas kontratës, dhe duhet të regjistrohet në klasën e pasurisë, ndërtimi i rrugëve, në regjistër të pasurisë.

Pagesat në vlerë 120,000€ dhe 16,528€ për mirëmbajtje verore të rrugëve si dhe pagesa në vlerë 42,264€ për mirëmbajtjen teknike të objekteve, ishin regjistruar si pasuri kapitale, duke mbivlerësuar regjistrin e pasurisë jo financiare kapitale.

Mangësitë e identifikuar lidhur me regjistrimet e pasurisë, kanë ndodhur për shkak të dobësive të zyrtarëve komunal në zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos regjistrimi i drejtë i pasurisë sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon në prezentimin e informatave jo të sakta në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara****Gjetja**

Vendimet përfundimtare të nënshkruara nga Kryetari i Komunës për shpronësimin e pronave parashohin që "Nga dita e hyrjes në fuqi e vendimit obligohet Organi Shpronësues (Komuna) që brenda afatit prej 24 muaj të paguaj plotësisht shumën e kompenzimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave".

Ne kemi vërejtur se Komuna në 13 raste obligimet financiare ndaj shpronësimeve në vlerë 4,373,191€, nuk i kishte paguar edhe pse afati i përcaktuar me vendime përfundimtare ishte brenda 24 muaj. Si rezultat i kësaj obligimet janë bartur për tu paguar vitin e ardhshëm.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ka vendos të bëjë shpronësime duke nxjerr vendime përfundimtare për shpronësime pa pasur mjete dhe pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve po i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo po përballet me padi nga pronarët e tokave, me ç'rast është e obliguar që përveç vlerës së tokës t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë shlyerjen e obligimeve të papaguara për shpronësim. Para së të vendos për shpronësimin e tokave të bëjë një analizë të mirëfilltë për të siguruar se do të këtë mjete të mjaftueshme buxhetore për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet e parapara të shpronësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2021 ishin në vlerë 4,837,641€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja A7 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale

Gjetja Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave.

Komuna e Gjilanit kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 34,143 objekte. Komuna në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 1234 objekteve apo rreth 4%.

Mos verifikimi i pronave kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm.

Ndikimi Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,354,440€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 6,266,743€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e objekteve administrative afariste, mirëmbajtje investive, blerjen e automjeteve etj.

Çështja B5 - Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve

Gjetja

Neni 36 paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat".

Në katër (4) raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale për pa pasur mjete mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjë me projektet:

- Furnizim me pajisje të Teknologjisë informative vlera e kontratës 127,740€, ndërsa vlera e zotimit 13,900€;
- Rikonstruimi i rrugës Adem Jashari dhe Zija Shemsiu vlera e kontratës 349,879€, ndërsa vlera e zotimit 58,864€;
- Furnizim me automjete të terrenit, pajisur me mjete medicinale vlera e kontratës 24,700€, ndërsa vlera e zotimit 8,185€; dhe
- Ndërtimi i tregut të gjelbër në Komunën e Gjilanit vlera e kontratës 509,177€, ndërsa nuk është ofruar zotimi para inicimit të procedurave të prokurimit a po para nënshkrimit të kontratës.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual si dhe të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 12,672,851€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë (10,590,361€), licencat e biznesit 1,747,025€, qiraja 296,854€ dhe tjerat 38,611€.

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna në vitin 2021 ka shpalosur në PFV llogaritë e arkëtueshme në vlerë 12,672,851€. Pjesa më e madhe i takon tatimit në pronë në vlerë 10,590,361€ apo rreth 84%, licensat e biznesit në vlerë 1,747,025€ apo rreth 14%, qiraja në vlerë 296,854€ apo rreth 2% dhe të tjera në vlerë 38,611€. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Në krahasim me vitin paraprak (11,997,965€) rritja ishte rreth 674,886€.

Dobësitë e identikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B6

Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	27,734,737	29,220,833	28,862,333	27,361,357	25,549,636
Grante Qeveritare - Buxheti	23,686,703	23,696,120	23,632,751	23,241,424	20,349,084
Financimi përmes huamarrjes	0	90,971	90,910	239,711	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	695,723	695,640	741,694	1,042,842
Të hyrat vetanake	4,048,034	4,048,034	3,866,687	2,608,996	3,880,386
Donacionet vendore	0	55,136	7,569	22,237	55,603
Donacionet e jashtme	0	634,849	568,776	507,294	221,721

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,486,096€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar rreth 99% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	27,734,737	29,220,833	28,862,333	27,361,357	25,549,636
Pagat dhe mëditjet	15,894,494	15,982,504	15,958,854	15,816,156	14,958,556
Mallrat dhe shërbimet	4,112,000	4,295,261	4,186,070	4,189,744	3,722,837
Komunalitë	671,500	671,500	588,601	456,408	515,226
Subvencionet dhe transferet	790,000	917,128	803,898	1,159,159	775,550
Investimet Kapitale	6,266,743	7,354,440	7,324,911	5,739,889	5,577,469

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
 Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 88,010€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen prej 10,317€, nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës, 25,152€ janë rritje nga donacionet si dhe 52,541 rritje nga huamarrja me vendim të qeverisë.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 183,261€, nga kjo vlerë: 900€ kishte zvogëlim nga rishikimi i Ligjit të Buxhetit, 56,300€ rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020, 123,917€, ishin nga donacionet si dhe rritje për 3,944€, nga huamarrja.

Buxheti final për shpenzime komunale nuk ka pësuar ndryshime krahasuar me buxhetin fillestar. Buxheti final për subvencione ishte rritur për 127,128€, nga kjo vlerë: 30,000€, rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020, dhe 97,128€, rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,087,697€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2020 në vlerë 609,423€, rritja prej 443,788€, ishin nga grandet e donatorëve si dhe 34,486€, rritje nga huamarrja.


Mjetet e bartura nga të hyrat vetjake ishin të dedikuara për financimin e projekteve kapitale si: Ndërtimi i tregut të gjelbër në vlerë 320,000€, Mirëmbajta investime publike 100,000€ dhe 189,423€ pagesa për shpronësime.

Buxheti nga grandet e donatorëve kryesisht ishte i dedikuar për rregullimin i platos mbi lumin Mirusha në vlerë 415,595€ dhe 28,163€ për agrobiznes.

Buxheti nga huamarrja në vlerë 34,486€ ishte për përkrahje e sektorit të arsimit në fushën e teknologjisë informative.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 505,517€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi dhe zjarrfikës.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2021 ishin 4,048,034€, përderisa ishin realizuar 4,837,641€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 769,238€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 16,938€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	4,048,034	4,048,034	4,837,641	2,758,090	3,765,119
Të hyrat tatimore	1,856,707	1,856,707	2,312,933	1,340,924	1,651,323
Të hyrat jo tatimore	2,191,327	2,191,327	2,505,694	1,417,166	2,113,795
Të hyrat tjera	0	0	19,014		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020, ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2020 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar; një (1) është zbatuar pjesërisht dhe shtatë (7) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që bëjnë procedimin e pagesave do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullat Financiare për shpenzimin e parave publike.	Fatkeqësisht kjo dukuri ka vazhduar edhe në vitin 2021, me ç'rast rastet kur urdhërblerja është lëshuar pas faturës dhe raportit të pranimit janë rritur krahasuar me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm të interesit. Po ashtu të sigurohet se nga operatori ekonomik fitues janë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve ndërtimore, Departamenti përkatës ka hartuar projektet dhe pjesën tjetër të dokumentacionit teknik-investigativ në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.	Nuk kemi hasur ndonjë rast që ka pas mungesë të projektit ekzekutiv.	I zbatuar
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Komuna edhe në vitin 2021 kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që para se të bëjë gradimet e stafit, së pari të sigurojë fondet e duhura buxhetore, ndërsa në bashkëpunim me Thesarin të fillojë pagesat e pagave të prapambetura sipas kontratave të nënshkuara.	Komuna në vitin 2021 pas pranimit raportit të auditimit e ka adresuar rekomandimin.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkallim të sasive të kontraktuara.	Janë identifikuar tejkallime të sasive indikative tek kontrata publike kornizë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e vlerësimit të tenderëve të krijohen kapacitete të mjaftueshme teknike të vlerësimit dhe të shpërblehen operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë më së miri kërkesat e dosjes së tenderit.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.	Nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.	Edhe në vitin 2021 kishte raste kur komuna ka iniciuar dhe lidhur kontrata pa zotime të mjaftueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të kryhet brenda afateve kohore të parapara me rregulloret e prokurimit.	Në mostrat tona të testuar për procedurat e prokurimit nuk kemi hasur probleme të kësaj natyre.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë.	Situatë e njëjtë ishte edhe në vitin 2021.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkon rregullorja në fuqi. Gjithashtu, komuna duhet të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth menaxhimit të pasurisë.	Gjendja është e njëjtë si në Raportin e Auditimit të vitit të kaluar. Meqenëse Sistemi i e-Pasurisë nuk kishte funksionuar dhe ky sistem mbahet dhe menaxhohet nga niveli qendror, Komuna pasurit jo kapitali i kishte regjistruar dhe mbajtur në Excel. Ne kemi konstatuar se edhe pse pasurit mbahen në Excel Komuna kishte llogaritur amortizimin për pasurit jo kapitale. Prandaj, këtë vit kjo do të jetë pjese e raportit të kapitulli i opinionit të auditimit në kuadër të çështjeve tjera.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Edhe vitin 2021, është raportuar se ka rritje të llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak dhe si rezultat ky rekomandim mbetet i pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi

14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të filloj të bëjë protokollimin/regjistrimin e të gjitha faturave në Librin e Faturave si dhe pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.	Komuna ka bërë protokollimin e faturave përmes sistemit elektronik që ka ku çdo faturë e pranuar ka numrin e vet që i cakton sistemi, ndërsa sa i përket vonesave mbetet i pazbatuar ende sepse pagesa e obligimeve të papaguara nuk bëhet me kohë.	Pjesërisht i zbatuar
-----	-----------------------	--	---	----------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Faik Thaqi, Anëtar i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjilanit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Alban Hyseni/Kryetar i Komunës

Data: 21 prill 2022, Gjilan.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.